



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25.02.2025

Nr: 160

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV BAZUAR NË DENONCIMIN NR. 17 ID,
DATË 17.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË KOALICIONIT
PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË
KONSOLIDUARA/KRIIK**

Sot më datë 25.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mori në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/
KRIIK

SUBJEKT: **Zj. Luneda Sufali**
Kryeinspektor, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor

Zj. Eugena Tomini
Drejtore e Përgjithshme, Instituti i Shëndetit Publik

Zj. Jeta Deda
Drejtore e Përgjithshme, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor

Zj. Florida Dobi
Drejtore, Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët

OBJEKT: Përdorimi në postimet e aktiviteteve institucionale të disa Institucioneve të varësisë së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të sloganeve/hashtag-eve partiakë/elektoralë

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe pika 2, neni 91, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të

Nr: 160

Data:25.02.2025

Ora: 14:00



“Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin nr. 17 ID, datë 17.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe institucione të konsoliduara /KRIIK”

ndryshuar, nënpika 1.3, pika c, të nenit 3 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), më datë 17.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 17 ID.

Në këtë denoncim, KRIIK parashtron sa vijon:

“Përgjatë gjithë periudhës parazgjedhore, në faqet zyrtare në “Facebook” të disa Institucioneve të varësisë së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë duke u përdorur sloganet elektorale të Partisë Socialiste, në formën e hashtag-eve.

Këto slogane është vërejtur se i përmban Faqja Zyrtare e Institucioneve të varësisë së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si:

- *Inspektorati Shtetëror Shëndetësor;*
- *Instituti i Shëndetit Publik;*
- *Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor;*
- *Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët.”*

Me vendimin nr. 109, datë 18.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), u vendos fillimi i procedurës administrative, për shqyrtimin e këtij denoncimi. Bazuar në këtë vendim, i'u kërkua personave përgjegjës pranë Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor (ISHSH), Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (OSHKSH), dhe Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët (QKTRF) për raportimin e veprimtarive publike, që të paraqesin prapësimet në lidhje me çështjen objekt hetimi.

KQZ administroi pretendimet e personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, nga ISHSH, ISHP, OSHKSH dhe QKTRF, të dërguara me e-mail në KQZ, të cilët deklaruan si vijon: Instituti i Shëndetit Publik deklaroi se:

“Ju sigurojmë që pas vlerësimit të materialeve me logo, menjëherë u be eliminimi i tyre nga faqja zyrtare e ISHP. Së dyti ju sigurojmë që nuk ka për të ndodhur në asnjë moment të dytë shpërndarja e informacionit shëndetësor me prezencë të logo-ve elektorale.”

Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor deklaroi se:

“Ju informojmë se për sa i përket Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (OSHKSH), publikimi i përmendur ka qenë një gabim i personit që administron faqen. Menjëherë, janë marrë masa për fshirjen e materialit nga faqja zyrtare dhe për të shmangur përsëritjen e këtyre situatave në të ardhmen.”

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, deklaroi se:

“Shpërndarja e postimeve në faqen zyrtare të “Facebook” është realizuar me qëllim informimin e qytetarëve në lidhje me shëndetin publik. Menjëherë pas marrjes së denoncimit kemi marrë masa për të fshirë postimet me përmbajtje elektorale.”

Institucioni Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët nuk i është përgjigjur emailit të dërguar nga KQZ.

Më datë 25.02.2025, ora 13:00, u zhvillua seanca dëgjimore, ku u ftuan të gjitha palët në proces për t’u shprehur në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi. Në tërësi palët iu qëndruan pretendimeve të paraqitura elektronikisht.

Në vlerësim të pretendimeve të palëve, fakteve dhe provave të administruara në këtë shqyrtim administrativ, çmuj se kërkimi sipas objektit i KRIIK, është i mbështetur në ligj, përkatësisht në nenin 91, pika, 1 të Kodit Zgjedhor, *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administruar të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”.* Po ky nen parashikon se *“burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit”.*

Vënia në dispozicion e faqeve zyrtare në “facebook” apo çdo mjeti tjetër elektronik (media sociale) të institucioneve publike për publikimin e postimeve apo të ripostimeve të cilat përmbajnë hashtag #, slogane me karakter politik/elektoral në zgjedhje, apo thirrje për mbështetje në zgjedhje nga ana e këtyre institucioneve përbën përdorim të burimeve publike.

Nga hetimi administrativ u provua se postimet, ripostimet dhe pëlqimet janë bërë në faqet zyrtare të rrjetit social “Facebook” të institucioneve subjekt i këtij denoncimi.

Pas verifikimeve të kryera nga ana jonë, u konstatua se postimet, ripostimet dhe pëlqimet, me karakter politik janë fshirë nga rrjetet sociale të institucioneve.

Sa më sipër, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi, duke i’u tërhequr vëmendje Drejtuesve të Institucioneve Publike që të tregojnë kujdes të shtuar në publikimin e postimeve apo ripostimeve të ndryshme me përmbajtje politike apo elektorale, duke mos lejuar shpërndarjen dhe ripostimin e veprimtarive politike apo elektorale të Institucioneve të tyre eprore, pasi përbën shkelje të dispozitave ligjore të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, nenin 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit nr.17 ID, datë 17.02.2025 të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ndaj:

Nr: 160

Data:25.02.2025

Ora: 14:00



“Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin nr. 17 ID, datë 17.02.2025 ID, të regjistrit të denoncimeve, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara /KRIIK”

- Zj. Luneda Sufali, Kryeinspektor i Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor;
 - Zj. Eugena Tomini, Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Shëndetit Publik;
 - Zj. Jeta Deda, Drejtor i Përgjithshëm i Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor;
 - Zj. Florida Dobi, Drejtor i Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

